

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS - VLADE KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA ARKIVA E MINISTROVE / SEKTOR I ARCHIVËS - OFFICE OF THE STATE MINISTER SEKTOR I ARCHIVËS - SEKTOR ARCHIVE - ARCHIVE SECTOR	
Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	01 1059/17
Nr. i faqes Broj. faqes No. pages	3- 10/04/2018 Prishtine/a



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E INOVACIONIT DHE NDËRMARRËSISË MINISTARSTVO ZA INOVACIJE I PRUDEZETNIŠTVO MINISTRY OF INNOVATION AND ENTREPRENEURSHIP Arkiva / Arhiva / Archive HYRËSE	
Nr./ Br.No. Nr. i faq / Br.st / No.pg. Data / Datum / Date	106 3 10 / 04 / 2018 PRISHTINE - PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë / Ministarstvo za Inovacije i Prudzetništvo
Ministry of Innovation and Entrepreneurship

Nr.prot: 106
 Data: 10/04/2018

Për: z.Ramush Haradinaj – Kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës
Cc: z.Besim Beqaj – Ministër i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë
Nga: z.Bujar Cakolli – Zëvendësministër i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë

Lënda: Raport i punës për periudhën tremujore **Janar - Mars 2018**

I nderuar Kryeministër,

Duke u bazuar në kërkesën tuaj nga takimi i dt: 28.12.2018 si dhe me qëllim të prezantimit të të arriturave po ju paraqesim një raport tremujor të punës time si Zëvendësministër i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, i cili është një konsiderim real i punës sonë gjatë këtij tremujori plot ritëm dhe bashkëveprim të ministrisë sonë dhe të gjitha strukturave tjera shtetore.

Raporti tremujor i Punës është një material që shpreh më së qarti hapat në të cilat kemi ecur, arritjet më të mira si dhe zhvillimet e përgjithshme në dikasterin tonë.

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ka intensifikuar veprimtarinë për hartimin e Strategjisë për Inovacion dhe Ndërmarrësi **2018-2023**, si dhe në një fazë të mëvonshme edhe të Ligjit për Inovacion dhe ndërmarrësi i cili do të mbështesë në mënyrë ligjore dhe institucionale aktivitetet e MIN, si dhe të bashkërendoj aktivitetet e ministrive të ndryshme lidhur me inovacionin dhe teknologjinë.

Përpjekje të rëndësishme janë bërë gjithashtu për stimulimin e aktiviteteve inovative në Republikën e Kosovës, të lidhura ngushtë me ndërmarrësinë dhe fushat tjera të ekonomisë, duke fuqizuar sektorin privat, nxitjen dhe promovimin e

bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe donatorët si dhe për forcimin e kapaciteteve administrative të ministrisë.

Hapa të rëndësishëm janë hedhur në drejtim të forcimit të funksionimit të kapaciteteve të brendshme administrative dhe ekspertizës në fusha të ndryshme.

Me qëllim të arritjes së objektivave të MIN të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në fuqizimin e rolit të sektorit privat deri me tani janë zhvilluar këto aktivitete:

- **Konstituimi i Ministrisë** - definimi i kompetencave, hartimi i rregullores së brendshme, përpilimi i draft-Buxhetit të Ministrisë për vitet 2017 dhe 2018.
- **Hartimi i programit të Ministrisë për vitet 2017-2021**
- **Themelimi i Këshillit Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi** - i cili kontribon në harmonizimin e politikave qeveritare dhe prioritet e sektorit privat.

Për ti dhënë kuptimin e duhur këtij raporti në aspektin përmbajtësor, më lejoni të përmend disa punë tjera që në cilësinë e Zëvendësministrit i kam kryer gjatë kësaj periudhe tremujore:

Aktivitete dhe takime tjera të realizuara:

- Udhëheqja e procesit për hartimin e Strategjisë për Inovacion dhe Ndërmarrësi
- Analizimi i përvojave të vendeve të rajonit dhe më gjerë për mënyrën e trajtimit/zhvillimit të fushës së inovacionit;
- Pjesëmarrja në Konferenca dhe takime të ndryshme;
- Takime me biznese të ndryshme;
- Shkëmbimi i përvojave me njohës të fushës së inovacionit nga ata vendorë dhe ndërkombëtarë;
- Takime të shumta me inovatorë potencial;

Konferenca, takime dhe vizita të ndryshme:

- **24, 25 dhe 26 Janar, Prishtinë** – Konferenca Internacionale “ Cybersecurity and Privacy” ;
- **8 Shkurt, Prishtinë** – Konferenca Ndërkombëtare “ Festimi i dhjetë vjetorit të Pavarësisë – Arritjet dhe Aspiratat” ;
- **13 Shkurt, Prishtinë - MIN** – Takim me LDA Prishtina rrethë organizimit të samitit ndërkombëtar “LEAP Prishtina 2018” ,
- **23 Shkurt, Gjakovë** – Konferenca “ Zhvillimi i ndërmarrjeve sociale nga perspektiva gjinore” ;
- **20 Mars, Prishtinë - MIN** – Takim me sipërmarrës Suedez në fushën e teknologjisë ;
- **26 dhe 27 Mars, Sofje – Bullgari -** Konferenca “ IT HUB CONNECT” ;
- **29 Mars, Prishtinë - UBT** – Vizite në Universitetin e Biznesit dhe Teknologjise - UBT
- **5 Prill, Mitrovicë** – Tryeza e rrumbullakët “ Institucionet e arsimit të lartë konform kërkesave të tregut rajonal dhe atij ndërkombëtar të punës” ;
- **10 Prill, Prishtinë - MIN** – Takim me OJQ-në “Germini”, për mbështetjen e projekteve inovative.

Si përfundim, jam i bindur se forcimi i kapaciteteve tona të brendshme në përmbushjen e misionit tonë, bashkëveprimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me akterët e tjerë, rritja e bashkëpunimit dhe përkrahjes për sektorin privat si dhe mbështetja direkte financiare e NVM-ve dhe bizneseve Start-up dhe iniciativave private me qëllim të zhvillimit të ideve inovative, janë parametra të cilët do të ndikojnë direkt në performancën tonë si Ministri e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë.

Bujar ÇAKOLLI
Zëvendësm ministër i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë – Ministarstvo za
Inovacije i Preduztnistvo – Ministry of Innovation and
Entrepreneurship

1. Zv. Bujar Cakolli, (dorëzuar me datë 10.04.18 – 3 faqe)